



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 17, Datë 16.01.2025

MBI

**DHËNIEN E GARANCISË SË ORIGJINËS PËR ENERGJINË ELEKTRIKE TË
PRODHUAR NE MUAJIN TETOR 2024 NGA PARKU FOTOVOLTAIK “BLUE 1” I
SHOQËRISË “SPV BLUE 1” SH.P.K.**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 22 të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; neneve 7 dhe 11 të Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme, miratuar nga bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) me vendimin nr. 229, datë 20.12.2019, i ndryshuar; nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, i ndryshuar; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 05.11.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 144 prot., datë 15.01.2025, të Drejtorisë së Zhvillimit të Politikave dhe Mbikëqyrjes së Burimeve të Rinovueshme të Energjisë “Mbi dhënie e garancisë së origjinës për energjinë elektrike të prodhuar në muajin tetor 2024 nga parku fotovoltaik “BLUE 1” i shoqërisë “SPV BLUE 1” sh.p.k.”,

Konstatoi se:

- shoqëria “SPV Blue 1” sh.p.k., me shkresën nr. SB1_2024_216 prot., datë 11.12.2024, protokolluar ne ERE me nr. 2526 prot, datë 11.12.2024, ka paraqitur kërkesën për pajisjen me Garancinë e Origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga impianti fotovoltaik “Blue 1” për muajin Tetor 2024.
- Shoqëria “SPV Blue 1” sh.p.k. është pajisur me certifikatë të garancisë së origjinës për sasinë e energjisë elektrike të prodhuar nga impianti fotovoltaik “BLUE 1” në muajt Qershor 2024, Korrik 2024 dhe Gusht 2024 respektivisht me vendimet e bordit të ERE nr. 158, datë 31.07.2024, nr. 189, datë 12.09.2024 dhe nr. 236, datë 05.11.2024.
- Referuar nenit 14.2 të “Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, të ndryshuar, pas lëshimit të certifikatës së parë të garancisë së origjinës, çdo aplikues që paraqet në ERE një kërkesë për Certifikatë Garancie Origjine do të depozitohet për qëllime të këtij aplikimi vetëm dokumentacionin që ka pësuar ndryshim referuar kërkesave të nenit 7, të kësaj rregulloreje.
- Shoqëria ka bërë me dije se dokumentacioni fillestar i depozituar në ERE për pajisjen me certifikatën e garancisë së origjinës nuk ka ndryshuar.

- Në vijim të kërkesës së paraqitur nga shoqëria “SPV Blue 1” sh.p.k., mbështetur në përcaktimet e pikës 6 të nenit 22 të ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, ERE me shkresën nr. 2589 prot., datë 20.12.2024, i është drejtuar operatorit të sistemit të transmetimit “OST” sh.a., me kërkesën për informacion për sasinë e energjisë elektrike faktike të prodhuar nga ky impiant, për periudhën 01.10.2024 – 31.10.2024.
- OST sh.a me shkresën nr. 8239/2 prot., datë 30.12.2024, protokolluar në ERE me nr. 4 prot., datë 06.01.2025, ka bërë me dije se sasia e energjisë së prodhuar bruto për periudhën 01.10.2024 – 31.10.2024 është 8,476.16 MWh.
- Për sa më sipër, konstatojmë se të dhënat e ardhura nga OST sh.a., janë të njëjta me ato të paraqitura nga shoqëria “SPV Blue 1” sh.p.k. dhe sasia prej 8,476.16 MWh do të merret në konsideratë për lëshimin e Garancisë së Origjinës, në zbatim të përcaktimeve të pikave 11.2 dhe 11.3 të Rregullores, ku parashikohet se Garancia e Origjinës lëshohet për një njësi të energjisë elektrike 1 MWh.
- Në referencë të përcaktimeve të nenit 22, pikës 5 të ligjit nr. 24/2023, *Garancia e origjinës është e vlefshme për një vit duke filluar nga dita e fundit e periudhës së prodhimit për të cilën është lëshuar.*

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Dhënien e Garancisë së Origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga parku fotovoltaiik “Blue 1”, i shoqërisë “SPV BLUE 1” sh.p.k., për periudhën 01 – 31 Tetor 2024, për sasinë 8,476 MWh.
2. Garancia e origjinës, e dhënë sipas përcaktimeve të këtij vendimi, është e vlefshme për 1 (një) vit duke filluar nga dita e fundit e periudhës së prodhimit për të cilën është lëshuar.
3. Drejtoria e Zhvillimit të Politikave dhe Mbikëqyrjes së Burimeve të Rinovueshme të Energjisë, të njoftojë shoqërinë “SPV BLUE 1” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI